

NJOFTIM

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në Statutin e UT-së, kërkon të punësojë në vendet e lira të punës për personel Ndihmës Akademik me karakter Administrativ me kohë të plotë pranë Njesisë Kryesore si më poshtë:

Kandidatët që konkurojnë për **“Specialist” në Degën e Projekteve** duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

1. Të jetë diplomuar në Master i Shkencave, Master Profesional ose DIND në Fushën e Shkencave Shoqërore (Humane).
2. Të njohë një prej pesë gjuhëve të huaja të BE-së: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht.
3. Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
4. Të njohë me dëshmi programet bazë kompjuterike.
5. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje.
6. Të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe të dijë të punojë në grup.
2. Të ketë minimumi 3 (tre) vite eksperiencë pune.

Kandidatët që aplikojnë për këtë vend pune duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës që aplikon;
2. Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV-Curriculum Vitae);
3. Diplomë dhe listë notash për të gjitha ciklet e studimeve universitare (të notuar). Për diplomat e marra në universitete të huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e notuar e certifikatës së njohjes nga strukturat përgjegjëse përkatëse ;
4. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj (të notuar);
5. Të paktën një referencë nga punëdhënësi i fundit;
6. Kopje e librezës së punës dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore;
7. Raport mjeko-ligjor për aftësinë në punë;
8. Fotokopje e dokumentit të identifikimit;
9. Dëshmi e zotërimit të programeve bazë kompjuterike;
10. Dëshmi penaliteti ose formular vetëdeklarim;

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrencës me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Afati i dorëzimit të dokumentave është nga data **09/09/2024 – 23/09/2024**.